



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 6, datë 03.02.2017

PËR LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" si dhe VKM nr. 958, date 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Gjrokastër me:

Drejtues Ligjor Bashkim Tola

Drejtues Teknik Besnik Kocaqi

2. Operatori Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Gjrokastër autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik

Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Gjrokastër.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 52, datë 06.07.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 06, DATË 03.02.2017 "PËR
LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR"**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Gjirrokastër sh.a. për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatohet se:

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Gjirrokastër është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 06, datë 03.02.2017, "Për licencimin e sh.a Ujësjetllës Kanalizime Gjirrokastër";
- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Gjirrokastër ka aplikuar me anë të shkresës nr.976 prot. datë 21.06.2018, për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor;
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Gjirrokastër sh.a. plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit mbi ndryshimin e drejtuesit ligjor, konkretisht:
 - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Drejtuesi ligjor plotëson kriteret e parashikuara në Rregulloren e Licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr. 06, datë 03.02.2017 "Për licencimin e sh.a. Ujësjetës Kanalizime Gjirokastrë " bëhen këto ndryshime:

"Drejtues ligjor Dhimitri Kristidhi"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI